



***MEMORANDUM BASHKËPUNIMI***

NDËRMJET

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE NË SHQIPËRI**

DHE

**AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
REPUBLIKA E KOSOVËS**

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DHE AGJENCIA  
SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS  
(në tekstin e mëtejme Palët),

**DUKE NJOHUR** kontributin e standardeve evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale në ndërtimin e institucioneve të të dy shteteve;

**DUKE MARRË PARASYSH** interesin e përbashkët në zhvillimin e bashkëpunimit bilateral në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;

**ME ANGAZHIMIN** për të zhvilluar më tej bashkëpunimin ndërmjet të dy vendeve të përqendruar në thellimin dhe forcimin e bashkëpunimit në procesin e zbatimit të legjislacionit respektiv të dy institucioneve për arritjen e objektivave të përbashkëta duke ruajtur identitetin e tyre të ndryshëm, qëllimet dhe objektivat e tyre;

**DUKE NJOHUR** nevojën për bashkëpunim ndërmjet Palëve për të arritur përparim të vazhdueshëm në ndërtimin e një sistemi efektiv të mbrojtjes së të dhënave personale;

**ME DËSHIRËN** për të filluar marrëdhëniet e ngushta dhe miqësore ndërmjet Palëve,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

### **Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme**

Sipas këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, Palët përcaktojnë fushat prioritare të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke përfshirë zhvillimin e institucioneve të sistemit të mbrojtjes së të dhënave personale (në tekstin e mëtejme "Memorandum").

### **Neni 2 Sferat e bashkëpunimit**

Bashkëpunimi do të zhvillohet në bazë të këtij Memorandumi për sa u takon sferave të mëposhtme:

- 1) Shkëmbimin e informacionit në dispozicion të publikut në lidhje me standardet e reja evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 2) Vizita dhe shkëmbimin e ekspertëve me qëllim të studimit të tipareve të funksionimit të sistemit institucional të mbrojtjes së të dhënave personale në shtetet e Palëve;
- 3) Shkëmbimin e informacionit mbi legjislacionin e miratuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në shtetet e Palëve;

- 4) Zhvillimin e propozimeve të përbashkëta (rekomandime) për përmirësimin e sistemit ekzistues të mbrojtjes së të dhënave personale në të dy vendet;
- 5) Krijimin e lidhjeve të ngushta në nivel ekspertësh të Palëve.
- 6) Shkëmbimin e ekspertëve në përputhje me nevojën, për t'i siguruar njëri tjetrit informacion në lidhje me mënyrat dhe metodat e përdorura për trajtimin e ankesave dhe kryerjen e inspektimeve.
- 7) Trajnimin dhe pjesëmarrjen në tryeza të rrumbullakëta; dhe
- 8) Forma të tjera të aktiviteteve të përbashkëta siç mund të bihet dakord reciprokisht mbi të.

### **Neni 3**

#### **Komunikimi i Palëve**

Brenda sferave të caktuara në Nenin 2 të këtij Memorandumi, bashkëpunimi midis Palëve kryhet drejtpërdrejtë midis autoriteteve kompetente të përmendura në këtë akt dhe përmes ekspertëve të caktuar prej tyre, si më poshtë:

- a. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe për raste të shpejta edhe verbalisht, por gjithsesi kërkesat verbale duhet të konfirmohen edhe me shkrim në një kohë të afërt;
- b. Çdo informacion që transmetohet nuk duhet t'u ekspozohet palëve të treta, pa dhënë për këtë aprovim me shkrim pala transmetuese.
- c. Palët do të caktojnë një person përgjegjës për zbatimin konkret të këtij memorandumi.
- d. Personat përgjegjës nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.
- e. Me anë të përfaqësuesve të dyja palët do të përcaktojnë radhën e takimeve, në interes të realizimit të angazhimeve.

### **Neni 4**

#### **Zbatimi dhe Financimi**

Palët do të kryejnë vlerësimin e përbashkët për implementimin e masave në bazë të këtij Memorandumi të paktën një herë në vit në formën e përshtatshme për ta.

Në mënyrë që të implementohet ky Memorandum, Palët do të shkëmbejnë informacion tek përfaqësuesit përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij Memorandumi brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të saj.

Çdo Palë do të mbajë shpenzimet e tyre lidhur me aktivitetet në bazë të këtij Memorandumi, përveç rasteve kur do të pranohet ndryshe nga Palët.

## Neni 5

### Konfidencialiteti

Gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, Palët mund të shkëmbejnë informacione të cilat ata i konsiderojnë konfidenciale. Të gjitha të dhënat e shkëmbyera midis Palëve që do të konsiderohen konfidenciale do të menaxhohen nga persona të caktuar nga palët në Memorandum, përveç rasteve kur ato përcaktohen ndryshe me shkrim.

## Neni 6

### Dispozitat përfundimtare

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga ana e Palëve dhe mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe.

Ky Memorandum nuk është një marrëveshje ndërkombëtare dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga ligjet ndërkombëtare.

Çdo Palë mund të ndërpresë marrëdhëniet në bazë të këtij Memorandumi, duke i dhënë njoftim me shkrim palës tjetër.

Bërë në ..... më ..... në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të gjitha kopjet janë njëloj autentike.

*Për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*

**Z. RUZHDI JASHARI**



*Për Komisionerin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale*

**Znj. Flora ÇABEJ (POGAÇE)**

